



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Sistemi i pavarur i ankesave dhe procedura e ankesës tek vlerësimet përfundimtare të nxënësve dhe vijuesve në arsimin dhe aftësimin profesional

NUMËR: 7/2007

DATË: 2.04.2007

Në bazë të nenit nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 27.7, 27.8 të Ligjit për arsim dhe aftësim profesional, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohet funksionimi i sistemit të pavarur të ankesave si dhe procedura e shqyrtimit të tyre tek vlerësimet përfundimtare të nxënësve, vijuesve (në tekstin e mëtutjeshëm **kandidatë**) në arsimin dhe aftësimin profesional.
2. Organet të cilat vendosin në qështjet administrative janë të obliguara që të sigurojnë realizimin efektiv të të drejtave dhe interesave të kandidatëve.

Neni 2

E drejta për ankesë

Të drejtë ankimi kanë të gjithë ata kandidatë të cilët nuk janë të kënaqur me procesin e verifikimit dhe vlerësimit të tyre.

Neni 3

Kushtet formale për zhvillimin e procedurës së ankimit

1. Ankimi mund të bëhet në formë të:

- a) kërkesës për rishqyrtim në shkallën e parë
- b) ankesës në shkallën e dytë.

2. Kërkesa e shkruar duhet të përmbaj:

- a) emrin dhe adresën e ankuesit (kandidatët);
- b) aktin administrativ të nxjerr apo të munguar, që kontestohet;
- c) shkaqet e ankimit;
- d) çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi.

Neni 4

Rregullësia e ankesës

1. Organi pranë të cilit është bërë ankimi apo të cilit i është drejtuar ankimi duhet që të shqyrtoj ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.
2. Ankimi pezullon zbatimin e aktit administrative
3. Zbatimi i aktit administrative nuk pezullohet vetëm në rastet e parapara në Ligjin e Procedurës Administrative (LPA).

Neni 5

Subjekti tek i cili dorëzohet ankesa

Kandidati ka të drejtë ankimi në dy shkallë të procedurës administrative:

1. në shkallën e parë me kërkesë për rishqyrtim në Këshillin provues të shkollës.
2. në shkallën të dytë me ankesë në Komisionin për Parashtrësia dhe Ankesa në MASHT-it.

Neni 6

Afati kohor për parashtrimin e ankimit dhe marrjen e vendimit

1. Afati për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim në organin e shkallës së parë është 48 orë pas publikimit të rezultatit të vlerësimit,
2. Organi i shkallës së parë (Këshilli provues i shkollës) është i obliguar që të vendos për kërkesën brenda 72 orë nga dita e pranimit të ankesës
3. Ankuesi ka të drejtë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë në organin e shkallës së dytë brenda 72 orëve nga dita kur kandidati ka marrë njoftimin nga organi i shkallës së parë.
4. Organi i shkallës së dytë (Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa/MASHT) është i obliguar që të vendos për ankesën në afat prej 8 ditësh.

Neni 7

Pavarësia në marrjen e vendimit

1. Organi kompetent për zhvillimin e procesit në mënyrë të pavarur përcakton faktet dhe rrethanat të cilat pasi që i vërteton aplikon dispozitat në rastin konkret.
2. Këshilli provues dhe Komisioni i Ankesave në MASHT në kuadër të autorizimeve që u janë dhënë me ligj zhvillojnë procesin dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur.
3. Gjatë vendosjes organi kompetent do të zbatojë parimin e vlerësimit të lirë të provave.

Neni 8

Aktet me të cilat vendosin organet kompetente

Organi i cili e shqyrton ankesën vendos:

- a) Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi aktin;
- b) Shfuqizimin e aktit dhe pranimin e ankesës;
- c) Ndryshimin (revokimin) e aktit administrativ duke pranuar pjesërisht ankimin;
- d) Detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerr aktin administrativ kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e tij.

Neni 9

Rishikimi administrative, gjyqësor

1. Me kërkesën e kandidatit çdo akt administrativ me natyrë diskriminuese mund të bëhet objekt i rishikimit administrativ apo gjyqësor.
2. Nëse kandidati i kanë shterrur të gjitha mjetet administrative të ankimit ai mund ti drejtohen gjykatës komunale.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Agim Veliu, ministër